



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**LIGJI Nr.2003/21**

**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 2003/2 “MBI MENAGJIMIN E FINANCAVE  
PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSIVE”**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë dhe përgjegjësisë të transferuara në Institucionet e Përkohëshme të Vetë-qeverisjes (IPVQ) nga Rregullorja Nr. 2001/9 të 15 Majit e Misionit të Administratës së Përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi “Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë”

Duke marrë parasysh kompetencat e rezervuara për PSSP-në nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9;

Gjithashtu duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/1 të 25 Korrikut 1999, “Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohëshme,” me ndryshime; dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/24 të 12 Dhjetorit 1999, “Mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë”, me ndryshime; dhe

Duke njohur nevojën për ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/2 “Mbi menagjimin e finacave publike dhe përgjegjësisë”, për t’a lejuar organizatën buxhetore t’i jap hua një entiteti të caktuar nëse Qeveria dhe PSSP formalisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimet e asaj huaje;

Miratton :

### Neni 1

Në Ligjin Nr. 2003/2 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, në nenin 44 pas paragrafit 44.3 shtohet paragrafi i ri 44.4 si vijon:

44.4. Pavarishtë nga dispozitat tjera të këtij neni, Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund t'u japë hua njësi të përcaktuara në listën A të këtij ligji, nëse Qeveria dhe PSSP-ja paraprakisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimet e një huaje të tillë.

### Neni 2

Në nenin 44.2 nën pikën (iii) t'i shtohet fjalia "përveç në rastin e përcaktuar në nenin 44.4"

### Neni 3 Fuqizimi

Ndryshimi i specifikuar në Nenin 1 dhe 2 do të fuqizohet menjëherë pas shpalljes së tij nga PSSP-ja.

**Ligji Nr.2003/21**  
**23 Tetor 2003**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

---

**akademik Nexhat Daci**